



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0548

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Vedat Poterqoi - Kryetar duke vendosur sipas ankesës së OE N.P.T. " Bajra ", kundër Vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me pajisje kundër zjarrit” me numër të prokurimit 632-23-6281-1-2-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – KOMUNA E GJAKOVËS, më 06/10/2023, mori këtë:

Vendim

1. Aprovohet, si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik “Bajra” N.P.T, e parashtruar në Organin Shqyrtues të Prokurimit me 07.08.2023 (me numër protokolli 548/23) vendimi për dhënie i AK për aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me pajisje kundër zjarrit “ me nr. të prokurimit: "632-23-6281-1-2-1", inicuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) - Komuna e Gjakoves, anulohet, ndërsa aktiviteti i prokurimit kthehet në ri-vlerësim.

2. Lejohet kthimi i shumës së deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës dhe obligohet operatori ekonomik ankesues që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale –

Me 19.06.2023, Komuna e Gjakoves , në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar njoftimin për kontratë për aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me pajisje kundër zjarrit” me nr. të prokurimit:” 632-23-6281-1-2-1 "Nderkaq me datën 20.07.2023 është publikuar njoftimi mbi vendimin e AK.

OE “Bajra” N.P.T me datën 25.07.2023 ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim në AK. Me datën 27.07.2023, AK- Komuna e Gjakoves me vendim ka refuzuar si te pa bazuar kërkesat per

rishqyrtim.

I pakënaqur me vendimin e AK-së, OE ankues “Bajra ” N.P.T me datën 07.08.2023 ka parashtruar ankesë në OSHP, me numër të protokollit 548/23, kundër vendimit të Autoritetit Kontraktues lidhur me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedure te hapur, lloji i kontratës: Furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: 10.000.00 €.

Ankesa e OE është ushtruar në pajtim me nenin 109.1, të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK çdo palë e interesuar mund të parashtrojë ankesë pranë OSHP. Meqë OE ka ushtruar po ashtu kërkesë për rishqyrtim, do të thotë se veprimet e të njëjtit i referohen po ashtu dhe nenit 108/A të Ligjit të cituar. Prandaj OSHP konsideron se Ankesa i plotëson kushtet e parapara në kuptim të dispozitave tani më të cituara dhe e njëjta bie nën kompetencat e tij në kuptim të nenit 105, të LPP.

- Vlerësimi dhe administrimi i provave –

Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka angazhuar ekspertin vlerësues në pajtim me nenin 111, paragrafi 5 të LPP, me detyrë që i njëjti në kuptim të nenit 113 të Ligjit të cituar, ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkitazi me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër. Lidhur me këtë, me 15.08.2023 eksperti shqyrtues ka dorëzuar Raportin e vlerësimit me rekomandimet si në vijim:

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e Grupit të OE “Bajra”N.P.T,

I. Refuzohet, ankesa e operatorit ekonomik “Bajra ”N.P.T, e parashtruar në Organin Shqyrtues të Prokurimit me 07.08.2023 (me numër protokollit 548/23) për aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me pajisje kundërzjarrit “ me nr. të prokurimit: "632-23-6281-1-2-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna e Gjakoves

II. Të mbetet ne fuqi vendimi I Autoritetit Kontraktues.

PËRGGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES

Sqarim hyrës:

Aktiviteti i prokurimit me titull " **Furnizim me pajisje kundër zjarrit**" me nr të prokurimit **632-23-6281-1-2-1**, inicuar nga **AK-Komuna e Gjakovës**, ka filluar me publikimin e njoftimit për kontratë me datë 19.06.2023, hapja e ofertave është bërë me datë 11.07.2023 gjerësa njoftimi mbi vendimin e AK-së publikohet me datë 20.07.2023.

OE ankuesi është vlerësuar si i pasuksesshëm ndërsa i rekomanduar për dhënje të kontratës është OE "ROI Consulting" SHPK.

OE ankuesi pas refuzimit të kërkesës për rishqyrtim, me datë 04.08.2023 parashtron ankesë në OSHP, duke pretenduar se AK ka shkelur nenet 1, 7, 28, 59 të LPP-së si dhe nenet 41, 26, 39 të Rrpp-së, i njëjti konsideron se OE i rekomanduar për kontratë nuk i plotëson kriteret dhe është i papërgjegjshëm pasi që AK nuk ka vlerësuar, krahasuar dhe analizuar ofertat konform LPP-së.

Përgjigje në pretendimet e OE ankuesit kundër OE të rekomanduarit:

Pretendimi i parë:

Ndërsa O.E i rekomanduar për kontratë ka dërguar vetëm deklaratën e specifikave ndërsa nuk ka ofruar asnjë dëshmi dokumentare mbi modelet e ofertuara dhe nuk ka ofruar asnjë dëshmi për standardet e pajisjeve.

Sipas RRUOPP, Neni 39, specifikimi teknik duhet të dërgohet i detajuar i nënshkruar dhe vulosur në të kundërtën tenderi duhet refuzuar pa kërkuar informacion të mëtejshëm . Pra, nuk mjafton vetëm një deklaratë pa bashkëngjitur specifikacionin teknik është sic e kërkon ligji atëherë kur bëhet fjalë për furnizime për të cilat është i mundur specifikimi apo detajimi teknik.

Sa i përket pretendimit të OE ankues lidhur me deklaratën mbi specifikimet teknike, ku OE ankuesi pretendon se OE i rekomanduar nuk ka deshmuar specifikat teknike, Ekspertja Shyrtuese pas analizimit, krahasimit të shkresave të lëndës sqaron se, në ofertën e OE të rekomanduarit është e bashkëngjitur deklarata për specifikimet teknike të detyrueshme, (shih mëposhtë):

DEKLARATË
ROA CONSULTING SH.P.K

Lidhur me aktivitetin e prokurimit “**Furnizim me paisje kundër zjarrit**” me nr. të prokurimit: **632-23-6281-1-2-1** të autoritetit kontaktues “**KOMUNA E GJAKOVËS**”

ROA Consulting SH.P.K me seli në Sallabajë - Lluzhan p.n, Komuna Podujevë, me numër unik identifikues 811949364, delaron se:

- Paisjet të cilat ju janë ofertuar dhe do të përdoren për këtë tender janë konform specifikave teknike të parashtruara nga Autoriteti Kontraktues si dhe në përputhshmëri me të gjitha aspektet dhe udhëzimet tjera në Aneksin 1 sipas dosjes së tenderit.
- Paisjet të cilat ju janë ofertuar për këtë tender, do të dorëzohen brenda një periudhe prej 15 ditë nga data e nënshkrimit të kontratës.



Date: 11/07/2023

Tel: +383 (0) 48 26 24 24
Email: roashpk@outlook.com

Dhe, kërkesa e AK-së në DT është si mëposhtë e cila është veqse pjesë e DT-së, ku AK tutje në paramasë ka cekur specifikat (pa kërkuar katalog) për të cilat OE i rekomanduar ka deklaruar që do ti plotësoj, andaj si e tillë konsideroj se deklarata mund të merret e mirëqenë, dhe se pretendimi i OE ankues nuk gjendet i bazuar.

Aneksi 1 SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME

1. Përshkruaj specifikimet teknike, në mënyrë jo diskriminuese, karakteristikat e detyrueshme të objektit të kontratës siç janë: Kualiteti, sigurimi i kualitetit, performanca, terminologjia, kërkesat e dizajnit, simbolet, dimensionet, testimi dhe metodat e testimit, sigurimi, paketimi, shënjimi, etiketimi.

Specifikimet teknike duhet të përpilohen në mënyrë që të përputhen me qëllimin e prokurimit dhe të ofrojnë qasje sa më të madhe të operatorët ekonomik të interesuar.

Autoriteti kontraktues është veçanërisht i ndaluar të vendosë specifikim teknik që favorizojnë ose dis-favorizojnë një ose më shumë operatorë ekonomik.

Përgjigje në pretendimin e dytë të OE ankues kundër OE të rekomanduarit:

Pretendimi II:

Operatori Ekonomik nuk ka ofruar dëshmi për përmbushje / realizim të kontratave të natyrës së ngjajshme për pajisje sipas kërkesës në këtë aktivitet prokurimi – Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe profesionale. Një mospërmbushje e tillë eliminon çdo OE pjesëmarrës në çfarëdo aktiviteti prokurimi, andaj konsiderojmë se jemi eliminuar padrejtësisht dhe se vlerësimi i ofertave është bërë në disharmoni të plotë me LPP-në.

Vetëm një kontratë është e realizuar e natyrës së ngjajshme në tërë listën e furnizimeve të bashkëngjitura si në vijim:

Id	Titulli i kontratës	Numri i kontratës	Data e kontratës	Data e realizimit	Vlera e kontratës	Emri i kontratës	Adresa e kontratës
9	FURNIZIME PËR PËRMBUSHJE	AK0010-20-02075-1-0-0	20.12.2022	19.01.2023	2.379.000 €	FURNIZIME PËR PËRMBUSHJE	Strada e Durrës, 10000

Të tjerat janë të pa pranueshme si furnizime pasi asnjëra prej tyre nuk ka të bëjë me pajisje apo natyrë si këto që janë kërkuar në këtë aktivitet.

Konta e kontratave të realizuara në 3 vjetë të fundit

Këshillë: Shumë AK i aplikojnë kërkesat e nenit 68 dhe/ose 69 të LPP-së edhe për rastet kur nuk kanë ndonjë rëndësi apo nevojë për tu dëshmuar (p.sh. për aktivitetet të cilat kanë për qëllim furnizimin me mallra e të cilat nuk prodhohen nga ofruesi i tyre). Në këto aktivitete aplikimi i kriterëve nga neni 68 dhe/ose 69 të LPP nuk është i arsyeshëm përkundrazi është jo profesional dhe mund të shkaktoj probleme të panevojshme.

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale	9.1 & 9.2	Kapaciteti teknik dhe profesional Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës së ngjajshme në 3 (tri) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për kontratë	<i>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</i> Lista e kontratave në të cilën specifikohen të gjitha furnizimet e realizuara në 3 (tri) vitet e shkuara, duke saktësuar furnizimet e kryera shumë e kontratës, datën e pranuesit ose certifikatën e ekzekutimit të mirë të furnizimeve – (së paku një referencë ose raport të pranimit të furnizimeve e cila përputhet me listën e dorëzuar)
---	-----------	---	--

Përgjigje në pretendimin e tretë të OE ankues kundër OE të rekomanduarit:

Pretendimi III:

Qe oferta e operatorit ekonomik është një ofertë e papërgjegjshme shihet edhe në cmimet e vendosura për pajisjet e kërkuara në paramasë. Pra, kemi të bëjmë me cmime jo normalisht të ulëta për disa pajisje për të cilat kërkohen standarde prodhimi dhe A-TEST raporte.

Operatori ekonomik i rekomanduar për tu shpërblyer me kontratë ka plotësuar vetëm ofertën financiare / paramasën duke mos treguar produktet me të cilat ka ofertuar. Nga tabela e mëposhtme / paramasa e vendosur në FDT-në e këtij aktiviteti shihen përveqse në Sqarimin Informues se pajisjet duhet të jenë kualitet dhe me standarde prodhimi dhe kjo për faktin që këto pajisje janë të destinuara për shuarje zjarresh nga njësite emergjencash.

Ekspertja Shqyrtuese sa i përket pretendimit të OE ankues kundër OE të rekomanduarit lidhur me cmimet jo normalisht të ulëta sqaron se, gjatë analizimit të paramasës së OE të rekomanduarit po ashtu edhe krahasimit të paramasës së OE ankuesit, mund të konsiderojmë se cmimet janë thujse të ngjajshme, duke përjashtuar pozicionin numër 6 "fryrëse zjarrëfikese me benzin" i cili cmim tek paramasa e OE ankuesit ka dallim rreth 50 % me i lartë nga cmimi i ofruar nga OE i rekomanduar, gjithashtu vlenë të theksohet se me një kërkim në internet lidhur me cmimet për këtë pozicion, vërejmë se janë cmime të ngjajshme sikur në paramasën e OE të rekomanduarit, e cila mbetet po ashtu në diskrecion të autoritetit konform rregullave mbi cmimet abnormalisht të ulëta, andaj si e tillë **pretendimi i OE ankues kundër OE të rekomanduarit nuk qëndron.**

Si përfundim, pretendimet e OE ankuesit kundër OE të rekomanduarit **konsideroj se janë të pa qëndrueshme**, gjithashtu pretendimet e të njejtit lidhur me arsyetimin se ka sjellë dëshmi plotësuese në ofertën e tij lidhur me specifikacionet teknike mendoj se nuk janë relevante, pasi që AK nuk ka kërkuar më tepër se sa kërkesat e vendosura në DT dhe në Paramasë, dhe si e tillë AK konform nenit 1 dhe 6 të LPP-së ka rekomanduar OE ROI Consulting SHPK të suksesshëm me cmimin më të ulët për 1,969.80 Euro.

- Konstatimet e panelit shqyrtues -

Palët janë në dijeni lidhur me shkresat e kësaj lënde sikurse kërkohet në pajtim me paragrafin 2, të nenit 20 të Rregullores së cituar dhe konstatohet se nuk ekzistojnë elementet për parandalim të konfliktit të interesit, siç kërkohet në kuptim të nenit 11 të Rregullores për Punën e OSHP. Prandaj Paneli analizoi në vijim shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe veprimet e

palëve dhe pohimet e tyre konsideroi se nuk ka nevojë të konvokohet seanca publike me palë sepse ka prova të mjaftueshme dhe ka kushte të vendoset në mënyrë meritore përkitazi me ankesën në rastin konkret, sikurse parashihet me paragrafin 1, të nenit 24 të Rregullores së cituar.

Paneli shqyrtues administroi me të gjitha shkresat e kësaj lënde, duke i analizuar të gjitha pohimet ankimore, aktet dhe veprimet e palëve të cilat (në përmbledhje) i shqyrtoi dhe si përfundim paneli shqyrtues do të ndalet vetëm tek pretendimi ankimor i OE, pretendim i cili përcakton dhe rrjedhën e vendimarrjes sa i përket shqyrtimit të kësaj lënde.

Pohimet ankimore të OE ankues

Ankuesi (me të dhëna si më sipër) ka atakuar vendimin e cituar si më sipër të AK nga aspekti i përgjegjshmërisë së OE të rekomanduar për kontratë duke pretenduar se AK ka bërë shkelje të dispozitave ligjore, ngase kundërligjshëm ka shpall fitues një OE i cili nuk ka dërguar specifikim teknik të detajuar të pajisjeve të ofruara, ashtu sikurse kërkohet me LPP (Neni 28), që d.t.th. nuk ka dëshmuar specifikat teknike dhe produktet me të cilat ka ofertuar. Lidhur me këtë ekspert shqyrtues ka deklaruar se AK në paramasë ka cekur specifikat (pa kërkuar katalog) për të cilat OE i rekomanduar ka deklaruar që do ti plotësoj, andaj si e tillë konsideroj se deklarata mund të merret e mirëqenë, dhe se pretendimi i OE ankues nuk gjendet i bazuar.

Për panelin shqyrtues ky konsiderim nuk paraqet pasqyrim të gjendjes reale, sepse detyrë e ekspertit ka qenë së të nxirret një konstatim i saktë i dispozitave ligjore dhe përmbushjes së kërkesave, ngase në AK specifikimet teknike i ka të detajuara tek përshkrimi i çmimeve. Megjithatë, paneli shqyrtues si rezultat i hulumtimit të të gjithë dokumentacionit dhe konsistencës në vendime nuk e mbështet konsiderimin e ekspertit shqyrtues. Për panelin shqyrtues ky pretendim ankimor është i bazuar, ngase në dokumentacionin e këtij aktiviteti rezulton se në ofertën e OE përkatësisht Specifikimet teknike, në asnjë vend nuk precizohet lloji i produktit se me cila se me cilat pajisje oferton. Një pjesë të gabimi e bartë vetë AK, i cili nuk ka kërkuar ndonjë katalog për produktet e ofruara dhe specifikimin teknik e ka vendos vetëm tek përshkrimi i çmimeve. Kjo definitivisht është edhe papërgjegjësi e plotë edhe e komisionit të vlerësimit por edhe e zyrtarit përgjegjës të prokurimit me kontraktin furnizime pa e ditur se çfarë do të pranoj, po ashtu, me këtë e vendos në pozitë të palakmueshme edhe komisionin e pranimit të mallit, i cili nuk ka mundësit me ditë se çka ka me pranë, kur dihet saktë se specifikimit teknik është pjesë e kontratës dhe furnizimi duhet të bëhet konform kontratës. Pra, duke ju referuar dokumentacionit të këtij aktiviteti të prokurimit rezulton se OE i shpallur fitues për këtë procedurë pikërisht tek specifikimet teknike të detyruara të ofruara në ofertën e tij nuk përcakton në asnjë vend produktin (llojin) apo prodhuesin e pajisjeve të cilat do ti liferoj apo me të cilët ka aplikuar. Dhe ka qenë përgjegjësi e tij të prezanton para AK produktin që oferton. Dokument i cili është relevant për këtë aktivitet është deklarata e OE i cili thekson se të gjitha produktet janë sipas specifikimit të kërkuara mirëpo prap edhe në deklaratën e tij nuk specifikohet produktin (llojin) apo prodhuesin e pajisjeve të cilat do ti liferoj apo me të cilët ka aplikuar.

- Përfundim -

Paneli shqyrtues konsideron pohimi i lartëcekur ankimor është i bazuar, sikurse është shpjeguar dhe si më sipër, kurse AK nuk ka vepruar në pajtim me dispozitat e nenit 27, 28, 59 dhe 60 të LPP. Kthimi i një aktiviteti të prokurimit në ri-vlerësim, me fakte dhe prova kontestuese dhe/ose

me bazë ligjore, është në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: “...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji”.

Lidhur me nenin 105, duke e pasur parasysh kërkesën e nenit 104, paragrafi 1, të Ligjit të cituar sipas të cilit, cituar: “Procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e drejtë, të ligjshme dhe efektive të lëndës...” Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Andaj nga të lartcekurat, paneli shqyrtues ne pajtim me nenin 117 të LPP-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KOMUNA E GJAKOVËS**
- **OE - N.P.T. " Bajra "**
- Arkivës së OSHP-së: